

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 37, dt. 05.03.2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07. 04. 2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 05. 03. 2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK),

VENDOSI:

1. Miratimin me shumicë votash të “Projekt i zgjerimit të rrugës “ Don Gjon Buzuku”, rijetëzimi i sheshit të Xhamisë së Iljaz Bej Mirahorit, rindërtimi i Kullës historike të Sahatit, rijetëzimi i sheshit të hyrjes dhe rikonstruksioni i disa rrugicave të pazarit historik, Korçë me këto sugjerime:
Sheshi të shtrohet njëtrajtësisht me pllaka në ngjyrë neutrale në konsultë me IMK.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI